

VENDIM
Nr. 700, datë 30.10.2019

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGESË TË QIRASË SË DISA
FAMILJEVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT ‘UNAZA E MADHE E
TIRANËS, SEGMENTI KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232 datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 1/3, shtohet pika 1/4, si më poshtë vijon:

“1/4. Familjet, sipas listës 2/4, përfitojnë subvencionimin e qirasë nga data 16.11.2018, sipas verifikimit të Njësisë Bashkiake nr. 6, të Bashkisë Tiranë. Shpenzimet për mbulimin e qirasë deri në fund të vitit 2019 mbulohen nga fondet e strehimit, të planifikuara në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.”.

b) Pas lidhjes 2/3, shtohet lidhja 2/4, me listën emërore të subjekteve që do të trajtohen me qira, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca 2/4

Lista emërore e subjekteve që trajtohen me qira

Subjektet, të cilat preken nga zbatimi i projektit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës, që trajtohen me pagesën e qirasë	
1	<i>Klodian Gjapi</i>
2	<i>Alfons Gjapi</i>